



Mesazh i Shoqatës Universale të Esperantos me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Prindore Me 21 shkurt 2025

Në vitin 2025 festojmë Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Prindore.

Kjo ditë e veçantë e shënuar nga Kombet e Bashkuara dhe Unesco menjëherë në fillim të shekullit 21 synon të kujtojë rëndësinë e gjuhëve për zhvillimin vetiak dhe pjesëmarrjen shoqërore dhe posaçërisht për të drejtën e fillimit të mësimin në gjuhën që në lindje për të mundur maksimalisht ta realizojë vetveten dhe maksimalisht të marrë pjesë në shoqëri që në nisje të jetës.

Pakësimi i ndryshimisë gjuhësore lidhet shpesh me pakësimin e ndryshimisë kulturore dhe të ndryshimisë biologjikë. Gjuhët bartin dije dhe përvoja të një brezi tek tjetri. Gjuhët na shoqërojnë kudo dhe në çdo veprim të jetës: në shtëpi, në arsim, në pjesëmarrjen politike, në arte dhe shkenca.

Mbajmë shënim që tani po përjetojmë Dhjetëvjeçarin Ndërkombëtar të Gjuhëve indigjene (2022-2032) që synon t'i shpjerë përpara të drejtat e njeriut të popujve indigjenë dhe të garantojë që ata të mund të ruajnë, të rigjallërojnë dhe të përhapin gjuhët prindore. Shoqata Universale e Esperantos e ka vendosur kongresin e saj të vitit 2022 në këtë Dhjetëvjeçar Ndërkombëtar.

Gjuhët kanë rëndësi për zhvillimin e qendrueshëm dhe për pjesëmarrjen e plotë në shoqëri. Çështjet gjuhësore nuk kanë marrë vëmendjen e nevojshme në debatin e përgjithshëm për Synimet për Zhvillim të Qendrueshëm.

Në vitin 2020 Shoqata jonë ka botuar në esperantisht Udhëzuesin e saj për 17 synimet për zhvillim të qendrueshëm. Udhëzuesi ka tërhequr vëmendjen se pa një komunikim gjuhësor ndikues Synimet nuk do mund të realizohen plotësisht- sepse gjuhët formojnë bazën e komunikimit dhe komunikimi dy drejtimesh është i nevojshëm për punën e përbashkët: gjuhët janë dhe për të folur dhe për të dëgjuar. Udhëzuesi thekson rëndësinë e mësimin të gjuhës për ta maksimalizuar dialogun për të arritur synimin e përbashkët: paqen, begatinë dhe ndërkuptimin. Ai shënon që ndër ato gjuhë, gjuha ndërkombëtare Esperanto nënvizon veçanërisht barazinë, paqen dhe bashkëpunimin.

E përsërisim: të drejtat gjuhësore kryejnë rolin thelbësor për ta shpënë përpara dialogun, bashkëpunimin, përfshirjen dhe shoqëritë e drejta. Ta mbajmë mend veçanërisht këtë me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Prindore 2025.